

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

Për auditimin e kryer në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër

I. Përmbledhje ekzekutive

Angazhimi i auditimit në Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) Shkodër u krye në mbështetje të ligjit nr.114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, Manualit të Auditimit të Brendshëm të miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.100, datë 25.10.2016 “Për miratimin Manualit të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik”, të ndryshuar si dhe Programit të Angazhimit të Auditimit miratuar me shkresën nr. 6681/2 prot, datë 21.12.2022.

- Sistemet e identifikuara lidhur me këtë angazhim janë: sistemi i prokurimeve të fondeve publike; sistemi i pagave dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore; për periudhën 01 qershor 2020 – 31 tetor 2022, për të vlerësuar kryerjen e veprimeve në përputhje me bazën ligjore në fuqi.
- Vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Gjetjet dhe konkluzionet

Sistemi i prokurimeve të fondeve publike
▪ Nga auditimi i procedurave të zhvilluara të blerjeve të vogla për vitin 2020, me vlerë nën 100,000 lekë me objekt: “Mirëmbajtje paisje zyre kompjuterike”, likuiduar në shumën 98,000 lekë me tvsh; “Blerje dokumentacion për zyrë”, likuiduar në shumën 112,560 lekë me tvsh; “Blerje kancelari”, likuiduar në shumën 109,350 lekë me tvsh; “Blerje materiale ndërtimi”, likuiduar në shumën 117,150 lekë me tvsh; “Lyerje të ambjenteve të brendshme”, likuiduar në shumën 117,000 lekë me tvsh; “Shërbim mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 114,000 lekë me tvsh; U konstatua se mungon testimi i tregut për përcaktimin e fondit limit, si dhe deklarata e konfliktit të interesit të KVO-së. ▪ Nga auditimi i procedurave të blerjeve të vogla të zhvilluara për vitin 2021 dhe 10 muji 2022, për blerjet me vlerë nën 100,000 lekë, me objekt: “Blerje tonera për printera”, likuiduar në shumën 119,820 lekë me tvsh; “Materiale të përgjithshme zyre”, likuiduar në shumën 112,640 lekë me tvsh; “Blerje vegla pune”, likuiduar në shumën 120,000 lekë me tvsh; “Mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 29,400 lekë dhe 13,500 lekë me tvsh; “Mirëmbajtje paisje zyre”, likuiduar në shumën 100,000 lekë me tvsh; “Blerje kosha mbeturinash”, likuiduar në shumën 119.970 lekë me tvsh; u konstatua se mungon testimi i tregut dhe procesverbali i llogaritjes së fondit limit, si dhe deklarata e konfliktit të interesit të KVO-së. ▪ Në procedurat me objekt: “Mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 29,400 lekë dhe 13,500 lekë me tvsh; mungon -Formulari nr. 4 “Procesverbali i Rasteve të Emergjencës”, i cili mbahet dhe nënshkruhet nga komisioni i blerjeve për aprovimin e çmimeve, dhe miratohet nga drejtori i institucionit.
Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.1 të Raportit
Sistemi i pagave dhe menaxhimi i burimeve njerëzore
▪ Për periudhën e audituar, rekrutimi i punonjësve administrativë është kryer nëpërmjet

procedurave të konkurimit; punonjësit janë marrë në punë nëpërmjet procesit të konkurimit, me njoftim dhe publikim në faqen e internetit të institucionit, apo në Buletinin e Njoftimeve Publike, dhe lidhja e kontratave është bërë pa afat për vitin 2021 dhe 10-mujorin e vitit 2022.

- Strukturat përkatëse në institucion nuk kanë kryer vlerësimin vjetor të punonjësve, si proces i identifikimit të nevojave për trajnime të tyre, por edhe i motivimit të punonjësve në punë.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.2 të Raportit

Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore

- Staf i DRTK Shkodër është përpjekur të respektojë Rregulloren e miratuar nga Ministri i Kulturës mbi funksionimin e sistemit të biletarisë në institucionet e trashëgimisë kulturore, përveç administrimit të dokumentacionit justifikues ose/dhe ID, që vërteton përkatësinë në kategorinë që përfiton hyrje pa pagesë ose biletë me çmim të reduktuar, të lëshuar nga institucioni përkatës; i cili është adresuar si problem gjatë punës në terren).
- Drejtori i institucionit ka përcaktuar në një akt administrativ të brendshëm shumën e limitit maksimal të vlerave monetare në biletari dhe në arkë si dhe frekuencën e kryerjes së kontrolleve pranë biletarive të kalave.

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV.3 të Raportit

Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar

- DRTK Shkodër funksionon pa Statut. ²
- Rregullore e brendshme duhet të rishikohet në lidhje me përcaktimin e procedurave të shpalljes së vendeve vakande. ³
- Nuk është hartuar regjistri i riskut, i cili do të përcaktojë ngritjen e kontrolleve efektive për minimizimin e riskut të identifikuar; e më pas vlerësimin e rishikimin e këtyre kontrolleve. ⁴

Më gjerësisht jemi shprehur në pikën IV. 5 të Raportit

Rekomandimet kryesore

- Bazuar në gjetjet e përmendura të këtij Raporti, rekomandimet kryesore konsistojnë në:
- Dokumentimin me procesverbal të treguesve të çmimit sipas tregut dhe përcaktimi i fondit limit në procedurat e prokurimit.
 - Deklarimin e konfliktit të interesit nga anëtarët e komisionit të blerjeve me vlera të vogla në gjithë rastet e blerjeve.
 - Rishikimin e Rregullores së Brendshme, në të cilën të përcaktohen saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të konkurimit publik.
 - Kryerja e vlerësimit objektiv vjetor i performancës së punonjësve mbi bazën e objektivave individuale vjetore, si dhe të identifikohen nevojat për trajnime të punonjësve (në rastet kur konstatohen mangësi).
 - Hartimin e draft statutit.
 - Hartimin e regjistrimit të riskut.

Më gjerësisht jemi shprehur në Aneksin nr.1, të rishikuar, bashkëlidhur Raportit

II. Hyrje

DRTK Shkodër funksionon sipas VKM nr.581, datë 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore” dhe sipas organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”. Numri i punonjësve të miratuar sipas strukturës është 22 veta dhe nuk ka ndryshuar për periudhën e audituar.

DRTK Shkodër ka për mision gjurmimin, studimin, projektimin, konservimin, restaurimin, mbikëqyrjen, kolaudimin, promovimin dhe publikimin e trashëgimisë kulturore për çdo territor që administron (sipas përcaktimit në VKM e sipërcituar).

Periudha e auditimit:	01 Qershor 2020 deri më 31 Tetor 2022
Afati i auditimit:	21.12.2022-23.12.2022
Grupi i auditimit:	Silvana Gushali Festim Ibrahim
Qëllimi i auditimit:	Të ndihmojë Drejtorinë Rajonale Trashëgimisë Kulturore Shkodër në realizimin e objektivave të veprimtarisë duke përmirësuar sistemet e kontrollit dhe kryerjen e veprimeve në përputhje me aktet ligjore në fuqi.
Takimi prezantues:	Datë 19.12.2022, i konfirmuar nga drejtori i institucionit.

Në zbatim të Manualit të Auditimit të Brendshëm, kapitulli IV, pika 4.1.12, pas dërgimit të Projekt Raportit të Auditimit të nënshkruar, shoqëruar me kthim përgjigje në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet, sipas shkresës së Drejtorit nr.140/2 prot., datë 05.04.2023, me nr.hyrës në Ministrinë e Kulturës 6681/4 prot., datë 07.04.2023, hartohet Raporti Përfundimtar i Auditimit, i cili i vihet në dispozicion subjektit të audituar “Drejtoria Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër”, për njohje dhe miratimin e Planit të Veprimit.

III. Metoda e Auditimit

Referuar objektit të auditimit metodat e auditimit u përzgjedhën:

- “Testimi hap pas hapi”
- “Rishikimi analitik”
- “Rindërtimi i ngjarjeve”
- “Inspektim fizik”

IV. Gjetjet dhe konkluzionet

Pas auditimit të të gjithë sistemeve të përcaktuara në programin e auditimit, grupi i auditimit jep vlerësimet e mëposhtme:

IV.1. Sistemi i prokurimeve të fondeve publike

Objekti i auditimit: Vlerësimi nëse parashikimi, realizimi i prokurimeve dhe raportimi janë në përputhje me legjislacionin në fuqi për prokurimet publike.

Fushat të cilat do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

- Hartimi i regjistrit vjetor të parashikimit të prokurimeve publike dhe raportimi i realizimit të tyre, sipas kërkesave të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për prokurimet.
- Ngritja e komisionit të përlllogaritjes së fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike; Përlllogaritja e vlerës së kontratës; dokumentimi i analizës së kostos për mallra, shërbime e punë; përgatitja e specifikimeve teknike, hartimi dhe argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit.
- Respektimi i dispozitave ligjore në procedurat e prokurimit të zhvilluara nga Autoriteti Kontraktor.
- Monitorimi i zbatimit të kontratave të lidhura.

Auditimi i prokurimit të fondeve publike është kryer sipas ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”; VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”; Udhëzimit të APP nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar dhe Udhëzimin e APP nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

Nga verifikimi rezultoi se për periudhën e audituar, për çdo vit ushtrimor është hartuar regjistri i parashikimit dhe realizimit vjetor të prokurimeve publike. Së bashku me ndryshimet e pësura gjatë ushtrimit vjetor, ato janë raportuar në organet kompetente në përputhje me afatet e parashikuara në dispozitat ligjore në fuqi.

Titullari i autoritetit kontraktor për çdo vit ushtrimor ka ngritur komisionin për blerjet me vlera të vogla në përbërje me tre punonjës. Urdhrat e brendshëm për ngritjen e komisionit me blerje të vogla janë përgatitur dhe protokolluar për çdo periudhë ushtrimore vjetore.

Autoriteti kontraktor ka përdorur procedurat e prokurimit me blerje me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbime, kur vlera e përlllogaritur është ndërmjet kufijve nga 100,000 lekë deri në 1,000,000 lekë në vit pa tvsh, sipas përcaktimit në pikën 2, të nenit 41, të LPP-së.

- Nga auditimi i procedurave të zhvilluara të blerjeve të vogla për vitin 2020, me vlerë nën 100,000 lekë, me objekt: “Mirëmbajtje paisje zyre kopmjuterike”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 128, datë 07.12.2020, në shumën 98,000 lekë me tvsh; “Blerje dokumentacion për zyrë”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 135, datë 07.12.2020, në shumën 112,560 lekë me tvsh; “Blerje kancelari”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 139, datë 11.12.2020, në shumën 109,350 lekë me tvsh; “Blerje materiale ndërtimi”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr.136, datë 11.12.2020, në shumën 117,150 lekë me tvsh; “Lyerje të ambjenteve të brendshme”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 140, datë 11.12.2020, në shumën 117,000 lekë me tvsh; “Shërbim mirëmbajtje makine”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr.143, datë 11.12.2020, në shumën 114,000 lekë me tvsh; U konstatua se mungon deklarata e konfliktit të interesit të KVO-së dhe testimi i tregut për përcaktimin e fondit limit.
- Nga auditimi i procedurave të zhvilluara të blerjeve të vogla për vitin 2021 dhe 10 mujorin e vitit 2022 rezultoi se: Për blerjet me vlerë nën 100,000 lekë, me objekt: “Blerje tonera për printera”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr.62, datë 16.07.2021, në shumën 119,820 lekë me tvsh; “Materiale të përgjithshme zyre”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 108, datë 23.11.2021, në shumën 112,640 lekë me tvsh; “Blerje vegla pune”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 135, datë 13.01.2022, në shumën 120,000 lekë me tvsh; “Mirëmbajtje makine”, likuiduar sipas urdhër-

shpenzimit nr. 136 dhe nr. 137, datë 13.09.2022, në shumën 29,400 lekë dhe shumën 13,500 lekë me tvsh; “Mirëmbajtje paisje zyre”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 103, date 19.10.2022, në shumën 100,000 lekë me tvsh; “Blerje kosha mbeturinash”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 110, datë 26.10.2022, në shumën 119.970 lekë me tvsh; U konstatua se mungon testimi i tregut dhe procesverbali i llogaritjes së fondit limit, si dhe deklarata e konfliktit të interesit të KVO-së.

- Ndërsa në procedurat me objekt: “Mirëmbajtje makine”, likuiduar sipas urdhër-shpenzimit nr. 136 dhe nr. 137, datë 13.09.2022, në shumën 29,400 lekë dhe shumën 13,500 lekë me tvsh; Mungon Formulari nr. 4 “Procesverbali i Rasteve të Emergjencës”, i cili mbahet nga komisioni i blerjeve për aprovimin e çmimeve dhe miratohet nga drejtori i institucionit.

1. Për periudhën e audituar në blerjet e vogla, nga verifikimi i procedurave lidhur me testimin e tregut dhe përcaktimin e fondit limit, rezultoi se per procedurat nën 100,000 lekë mungon *testimi i tregut për përcaktimin e fondit limit*. Komisioni i blerjeve, *nuk ka bërë testimin tregut për përcaktimin e fondit limit*, të cilat i pasqyrojmë në vijim.

Titulli i gjetjes: Për procedurat e blerjeve të vogla me vlera nën 100,000 lekë pa tvsh, nuk ka testim tregu për llogaritjen e fondit limit.

Gjetje nr. 1	
Subjekti i audituar	DRTK Shkodër
Njësit/subjektet e interesuara	Drejtori i DRTK Shkodër Komisioni i blerjeve të vogla
Përmbledhje e bazës ligjore	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Udhëzimi i APP nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlera të vogla”. Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Për vitin 2020: 1. Nga auditimi i procedurave të zhvilluara me blerje me vlerë nën 100,000 lekë me objekt: “Mirëmbajtje paisje zyre kompjuterike”, likuiduar në shumën 98,000 lekë me tvsh; “Blerje dokumentacion për zyrë”, likuiduar në shumën 112,560 lekë me tvsh; “Blerje kancelari”, likuiduar në shumën 109,350 lekë me tvsh; “Blerje materiale ndërtimi”, likuiduar në shumën 117,150 lekë me tvsh; “Lyerje të ambjenteve të brendshme”, likuiduar në shumën 117,000 lekë me tvsh; “Shërbim mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 114,000 lekë me tvsh; U konstatua se komisioni i blerjeve nuk ka bërë testimin e tregut për përcaktimin e fondit limit dhe administrimin e tre ofertave. Për vitin 2021 dhe 10 mujorin e vitit 2022: 1. Në procedurat e prokurimit nën 100,000 lekë me objekt:

	“Blerje tonera për printera”, likuiduar në shumën 119,820 lekë me tvsh; “Materiale të përgjithshme zyre”, likuiduar në shumën 112,640 lekë me tvsh; “Blerje vegla pune”, likuiduar në shumën 120,000 lekë me tvsh; “Mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 29,400 lekë dhe 13,500 lekë me tvsh; “Mirëmbajtje paisje zyre”, likuiduar në shumën 100,000 lekë me tvsh; “Blerje kosha mbeturinash”, likuiduar në shumën 119.970 lekë me tvsh; U konstatua se mungon testimi i tregut dhe procesverbali i llogaritjes së fondit limit. Kriteri: Në pikën 5, të udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin procedurës së prokurimit me vlerë të vogël”, përcaktohet: “Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specifikimet teknike, duhet të përlllogarisë fondin limit për sasi të mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurohen, në përputhje me nenin 59, të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. Sipas nenit 12 dhe 13, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Në pikën 7, të udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, përcaktohet: “Në rastet kur në përlllogaritjen e fondit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij procesi, por vetëm treguesit e çmimeve, të cilat dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël”. Ndikimi/Efekti: Shpallja fitues e operatoreve ekonomik, me procedurë të drejtëpërdrejtë, pa kryer testim të tregut dhe përcaktimin e fondit limit, <i>ka sjellë mos pasqyrimin e çmimeve reale në treg, në realizimin e procedurave të blerjes.</i> Shkaku: Mungesa e përditësimit me aktet nënligjore në fuqi, nga komisioni i blerjeve dhe strukturave përgjegjëse të institucionit.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I mesëm
Konkluzioni	Për blerjet nën 100,000 lekë, institucioni nuk ka kryer testim të tregut dhe nuk ka dokumentuar treguesit e çmimeve në një procesverbal, mbi bazën e të cilit përcaktohet edhe fondi limit i blerjes së mallit apo shërbimit në procedurat e prokurimit.
Rekomandimi	Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të kryejë testimin e tregut të dokumentojë treguesit e çmimeve në një procesverbal, dhe të kryej përcaktimin e fondit limit.
Afati i fundit për zbatimin	Në vijimësi

e rekomandimeve	
Statusi i rekomandimit	Është kundërshtuar gjetja për 5 procedurat me blerje të vogla, të zhvilluara në elektronike, por nuk ka ndryshuar trajtimi i gjetjes. Audituesi i brendshëm ka dhënë argumentimet bashkëlidhur gjatë trajtimit të observacionit, rekomandimi nuk është kundërshtuar në observacion.

2. Në procedurat me prokurim të drejtëpërdrejtë, të realizuara për periudhën e audituar, rezultoi se mungon formulari i deklarimit të konfliktit të interesit, ku anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla vetëdeklarojnë nëse ndodhen ose jo në kushtet e konfliktit të interesit.

Titulli i gjetjes: Mosdeklarimi i konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël

Gjetje Nr. 2	
Subjekti i audituar	DRTK Shkodër
Subjektet e interesuara nga gjetja	Drejtori i DRTK Shkodër Komisioni i blerjeve të vogla
Përmbledhja e bazës ligjore	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar. VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Në 12 procedura të prokurimit me blerje me vlera të vogla të drejtëpërdrejta, rezultoi se mungon formulari i deklarimit të konfliktit të interesit, nëpërmjet të cilit anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla vetëdeklarojnë nëse ndodhen ose jo në kushtet e konfliktit të interesit; konkretisht procedurat sipas objekteve: <u>Procedura të zhvilluara të blerjeve të vogla për vitin 2020:</u> 1- Procedura e prokurimit “Mirëmbajtje paisje zyre kopmjuterike”, likuiduar në shumën 98,000 lekë me tvsh; 2- Procedura e prokurimit “Blerje dokumentacion për zyrë”, likuiduar në shumën 112,560 lekë me tvsh; 3- Procedura e prokurimit “Blerje Kancelari”, likuiduar në shumën 109,350 lekë me tvsh; 4- Procedura e prokurimit “Blerje Materiale ndërtimi”, likuiduar në shumën 117,150 lekë me tvsh; 5- Procedura e prokurimit “Lyerje të ambjenteve të brendshme”, likuiduar në shumën 117,000 lekë me tvsh; 6- Procedura e prokurimit “Shërbim mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 114,000 lekë me tvsh; <u>Procedura të zhvilluara të blerjeve për vitin 2021 dhe 10 mujori 2022:</u> 7- Procedura e prokurimit “Blerje Tонера për printera”, likuiduar në shumën 119,820 lekë me tvsh; 8- Procedura e prokurimit “Materiale të përgjithshme zyre”, likuiduar në shumën 112,640 lekë me tvsh;

	9- Procedura e prokurimit “Blerje Vegla pune”, likuiduar në shumën 120,000 lekë me tvsh; 10- Procedura e prokurimit “Mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 29,400 lekë dhe 13,500 lekë me tvsh; 11- Procedura e prokurimit “Mirëmbajtje paisje zyre”, likuiduar në shumën 100,000 lekë me tvsh; 12- Procedura e prokurimit “Blerje Kosha mbeturinash”, likuiduar në shumën 119.970 lekë me tvsh. Autoriteti kontraktor nuk ka respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me plotësimin e Formularit të deklarimit të konfliktit të interesit, nëpërmjet të cilit anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla vetëdeklarojnë nëse ndodhen ose jo në kushtet e konfliktit të interesit. Kriteri: - Në pikën 2, të nenit 64, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: <i>“Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshkruajnë një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës”.</i> Agjencia e Prokurimit Publik, në njoftimin nr. 6504/3 prot., datë 26.09.2018, drejtuar autoriteteve kontraktore ka dhënë sqarimin se, në bazë të dispozitës së sipërcituar, anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në momentin e hapjes së ofertave në procedurat përkatëse të prokurimit, kanë detyrimin të deklarojnë mbi gjendjen e konfliktit të interesit, nëpërmjet nënshkrimit të një deklarate. -Në pikën 4, të nenit 73, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: <i>“Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e çdo rëpunësi, të angazhuar në procesin e prokurimit. Çdo nëpunës, që marr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit”.</i> Ndikimi/Efekti: Moszbatimi i këtij detyrimi ligjor, krijon kushtet që anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, të shpallin fitues operatorë ekonomikë, me të cilët mundet të ndodhen në kushtet e konfliktit të interesit. Shkak: Mungesa e përditësimit me aktet ligjore dhe nënligjore, si dhe me rekomandimet dhe njoftimet e Agjencisë së Prokurimit Publik.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I mesëm

Konkluzioni	Autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për deklarimin e gjendjes së konfliktit të interesit, në momentin e caktimit në komision të blerjeve me vlera të vogla.
Rekomandimi	Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël të deklarojnë rabi gjendjen e konfliktit të interesit, nëpërmjet nënshkrimit të një deklarate.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Në vijimësi
Statusi i rekomandimit	Është kundërshtuar gjetja në një procedurë me blerje të vogla elektronike, por nuk ka ndryshuar trajtimi i gjetjes. Është rishikuar rumri i trajtimit të rasteve, sipas argumentimet të audituesit të brendshëm gjatë trajtimit të observacionit, bashkëlidhur raportit. Rekomandimi nuk është kundërshtuar në observacion.

3. Gjatë auditimit të procedurave për blerjet me vlerë nën 100,000 lekë pa tvsh për 10-mujorin 2022, blerje me objekt: “Mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 29,400 lekë dhe 13,500 lekë me tvsh, rezultoi se në të dy procedurat komisioni i blerjeve nuk ka dokumentuar Formularin nr. 4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës”, me të cilin aprovohen çmimet për blerjen sipas faturës së lëshuar nga Operatori Ekonomik, i cili nënshkruhet nga komisioni i blerjeve dhe miratohet nga titullari i Autoritetit Kontraktor.

Titulli i gjetjes: Mungesa e dokumentimit të Formularit nr. 4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës”, nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla

Gjetje nr. 3	
Subjekti i audituar	DRTK Tiranë
Njësit/subjektet e interesuara	Titullari i Autoritetit Kontraktor Komisioni i blerjeve të vogla
Përmbledhje e bazës ligjore	Udhëzimi i APP-së nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nga auditimi i 2 procedurave të prokurimit me vlera të vogla të realizuara gjatë 10 mujorit të vitit 2022 me procedurë drejtpërdrejtë, emergjente, për blerjet me vlerë nën 100,000 lekë, rezultoi se mungon Formulari nr. 4 “Procesverbali i Rasteve të Emergjencës”, konkretisht: 1-Procedura e prokurimit “Mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 29,400 lekë me tvsh; 2-Procedura e prokurimit “Mirëmbajtje makine”, likuiduar në shumën 13,500 lekë me tvsh. Autoriteti kontraktor nuk ka respektuar përcaktimet ligjore në lidhje me dokumentimin e blerjeve me vlera të vogla me Formularin nr. 4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës” sipas udhëzimit të APP-së. Kriteri: - Udhëzimi i APP-së nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete

	elektronike”, Pika 7, ku citohet: “AK mund të përdorë procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për blerjen e mallrave, për të cilat ka nevojë emergjente, apo për kryerjen e shërbimeve të paparashikueshme me kusht që vlera e përlogaritur e mallrave dhe shërbimeve nuk është më e madhe se 100,000 lekë pa tvsh”. - Në të tilla raste emergjente, blerja apo shërbimi do të kryhet në vend pa u respektuar procedura e parashikuar në pikën 5 të këtij udhëzimi, në prani të personave (përfaqësues të institucionit) që ndodhen në vend dhe që mbajnë një procesverbal midis tyre për ngjarjen e ndodhur. - Procesverbali i mbajtur midis personave të pranishëm së bashku me faturën përkatëse të nënshkruar prej tyre, i dorëzohen komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, të cilët mbajnë procesverbalin, sipas formularit nr.4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës”, bashkëlidhur këtij Udhëzimi, nënshkruajnë faturën dhe të gjithë dokumentacionin dhe ia dërgojnë Zyrës së Financës për likuidim” etj. Ndikimi/Efekti: Shmangia e dokumentimit sipas udhëzimit përkatës të procedurave emergjente nga komisioni, mund të shkaktojë ruajtje dhe administrim jo efektiv të mallrave e materialeve në magazinë apo shërbimeve të kryera në institucion. Shkak: Mungesë vullneti nga komisioni i blerjeve dhe titullari i AK, për zbatimin e kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin e APP-së nr. 5, datë 25.06.2021, në lidhje me blerjet emergjente dhe dokumentimi sipas formularit nr. 4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës”.
Vlerësimi i nivelit të riskut (i lartë, i mesëm, i ulët)	I ulët, për shkak se mundësia e ndodhjes është e ulët (konstatuar vetëm në dy raste) dhe ndikimi në fondet e shpenzimeve operative është i ulët.
Konkluzioni	Komisioni i blerjeve të AK për blerjet e paparashikuara, nuk ka dokumentuar Formularin nr. 4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës”, dhe aprovimin e çmimeve sipas faturave të lëshuara nga OE, dhe pastaj të dërgohet në Zyrën e Financës për likuidim. Procedurat e prokurimit në këto raste, nuk kryhen në Sistemin e Prokurimit Elektronik.
Rekomandimi	Të gjitha procedurat emergjente ose të drejtëpërdrejta, përveç të tjerave, duhet të dokumentohen me Formularin nr. 4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës”.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimeve	Menjëherë dhe në vijimësi
Statusi i rekomandimit	Nuk është paraqitur koment për gjetjen

4. Në drejtim të monitorimit të zbatimit të kontratave si dhe procedurave të blerjeve me vlera të vogla të kryera gjatë vitit 2020-2021 dhe 10 maji 2022, u konstatua se bashkëlidhur urdhër

shpenzimit të likuidimit të mallit/shërbimit, ndodhen gjithë dokumentet justifikuese, ndër të cilat edhe procesverbali i marrjes në dorëzim të mallit/shërbimit, etj); duke vlerësuar punën e mirë në këtë drejtim.

Në përfundim të trajtimit të këtij sistemi vlerësojmë përpjekjet e punonjësve për kryerjen e veprimeve në përputhje me bazën ligjore të prokurimeve, por gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimeve me vlera të vogla, punonjësit e caktuar në komisionin e blerjeve të vogla, në çdo rast të blerjeve nën dhe mbi 100,000 lekë duhet të kenë në vëmendje: deklarin e konfliktit të interesit; dokumentimin në një procesverbal të treguesit real të çmimeve të tregut të cilat ndikojnë në përcaktimin e fondit limit për procedurat elektronike.

Punonjësit e komisionit të blerjeve me vlera të vogla të përditësohen në vijueshmëri me përcaktimet në bazën ligjore të prokurimeve publike.

IV.2 Sistemi i pagave dhe menaxhimi i burimeve njerëzore

Objektivi i auditimit: Vlerësimi nëse burimet njerëzore menaxhohen në përputhje me aktet ligjore në fuqi dhe me strukturën organizative të miratuar.

Fushat që do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

- Respektimi i numrit të punonjësve në total dhe sipas emërtimeve për çdo pozicion me strukturën organizative të miratuar.

Nga auditimi i ushtruar rezultoi se për periudhën e audituar është respektuar numri i punonjësve, sipas strukturës së miratuar me Urdhrin nr. 139, datë 21.10.2019, të Kryeministrit, “Për Miratimin e Strukturës dhe të Organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”; numri i punonjësve gjithsej është 22 veta.

Përveç numrit të miratuar në strukturë, gjatë periudhës së audituar disa aktivitete janë kryer nga punonjës të përkohshëm me kontratë të përkohshme, sipas përcaktimeve në vendimet përkatëse të këshillit të ministrave.

- Procedurat ligjore të emërimeve të personelit në punë duke filluar nga kërkesa për vend të lirë, shpallja e deri tek lidhja e kontratës së punës, si dhe ndjekja e procedurave ligjore për largimet e personelit nga puna.

Për periudhën objekt auditimi, nga përzgjedhja e procedurës së rekrutimit për pozicionin e punës “Përgjegjës i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse”, rezultoi se është kryer nëpërmjet procedurave të konkursit. Konkursi është zhvilluar sipas përcaktimeve në rregulloren e brendshme të institucionit. Njoftimi i konkursit është publikuar në faqen e internetit të institucionit, si edhe në Buletinin e Njoftimeve Publike. Në përfundim të procedurës është shpallur fitues kandidatja D. M., e cila plotësonte kriteret e përcaktuara sipas “Shpalljes Për Konkurim Publik” nr. 244/5 prot, datë 20.07.2022 dhe “Rishpalljes Për Konkurim Publik” nr. 244/8 prot, datë 04.08.2022, të vendit të punës provizor “Përgjegjës i Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse”.

Gjithashtu rezultoi se marrja në punë e dy punonjësve (sanitare, mirëmbajtës) për punë provizore (sezonale) për çdo vit në muajt Prill-Shtator, është kryer sipas VKM-së “Për punonjësit me kontratë të përkohshme”.

- Përshtatja e diplomës me vendin e punës sipas strukturës së miratuar me Urdhër të Kryeministrit të RSH.

Nga auditimi i kësaj fushe, referuar rastit të trajtuar të emërimit si dhe verifikimit për 12 punonjës të tjerë rezultoi përshtatje e diplomës me vendin e punës.

- Përshkrimet e punës dhe vlerësimi vjetor i performancës në punë.

Nga auditimi i kësaj fushe në dosjet e personelit, rezultoi se përshkrimet e punës së punonjësve janë pjesë e çdo kontratë individuale të punës të kryer sipas nenit 21 “Përshkrimet individuale të punës” të Rregullores së Brendshme; ndërsa vlerësimi vjetor i performancës në punë të punonjësve nuk është kryer mbi bazën e objektivave individuale vjetore dhe sipas nenit 22 “Vlerësimi i performancës”, të Rregullores së Brendshme.

Titulli i gjetjes: Mungesa e kryerjes së vlerësimit objektiv vjetor të performancës mbi bazën objektive individuale vjetore.

Gjetje Nr. 1	
Subjekti i audituar	Drejtoria Rajonale Trashëgimisë Kulturore Shkodër
Subjektet e interesuara nga gjetja	Nëpunësi Autorizues Specialiste e Burimeve Njerëzore
Përmbledhja e bazës ligjore	Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhërin nr. 108, datë 17.11.2016, të Ministrit të Financave; Rregullorja e brendshme e institucionit nr. 161 prot, datë 07.05.2020 “Për organizimin dhe funksionimin e DRTK Shkodër”.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se specialiste e burimeve njerëzore dhe Drejtori nuk kanë kryer vlerësimin objektiv vjetor të performancës mbi bazën e objektivave individuale vjetore, si dhe nuk kanë kryer identifikimin e nevojave për trajnime (në rastet kur konstatohen mangësi), për vitet ushtrimore të periudhës së audituar Qershor 2020 – Tetor 2022. Kriteri: - Në Kapitullin III “Komponentët e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pika 3.1. “Mjedisi i kontrollit të brendshëm, të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, miratuar me Urdhërin nr. 108, datë 17.11.2016, të Ministrit të Financave, përcaktohet: “Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë: Një system për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndërkalojë në rast të kundërt”; - Sipas nenit 22 “Vlerësimi i performancës”, të Rregullores së Brendshme nr. 161, datë 07.05.2020, citohet: “1. Vlerësimi i performancës është procesi vjetor i verifikimit të realizimit të përgjithshëm të objektivave, realizimi i punës me cilësi dhe në kohë, si edhe i aftësive apo dobësive të punonjësit në kryerjen e detyrave; 2. Vlerësimi i rezultateve në punë është një proces që përsëritet një herë në vit, në periudhën midis datës 31 Tetor – 15 Nëntor;

	3. Në varësi të strukturës organizative, vlerësimi do të bëhet nga përgjegjësi i sektorit dhe nga Drejtori i DRTK-së; 4. Formulari i vlerësimit gjendet bashkëlidhur rregullores në formën e aneksit; 5. Proçesit të vlerësimit i nënshtrohen të gjithë punonjësit administrativë të institucionit, me përjashtim të punonjësve mbështetës”. Ndikimi/Efekti: Mungesa e vlerësimit objektiv vjetor të performancës së punonjësve mbi bazën e objektivave individuale vjetore, ka çuar në mungesën e identifikimit të trajnimeve të punonjësve (në rastet kur konstatohen mangësi), por edhe në mungesën e motivimit të punonjësve, në rast të moskonstatimit të mangësive. Shkak: Mungesa e zbatimit të rregullores së brendshme të institucionit dhe akteve ligjore e nënligjore, nga ana e strukturave përgjegjëse.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I Lartë - Mos kryerja e vlerësimit objektiv vjetor të performancës të punonjësve për gjithë periudhën e audituar, mbi bazën e objektivave individuale vjetore, ndikon në performancën e dobët dhe motivimin e punonjësve.
Konkluzioni	Specialistja e burimeve njerëzore dhe Nëpunësi Autorizues në institucion, bazuar në dispozitat ligjore duhet të kryejnë vlerësimin vjetor të punonjësve, si proces i identifikimit të nevojave për trajnime të tyre, por edhe i motivimit të punonjësve në punë.
Rekomandimi	Të kryhet vlerësimi objektiv vjetor i performancës së punonjësve mbi bazën e objektivave individuale vjetore, si dhe të identifikohen nevojat për trajnime të punonjësve (në rastet kur konstatohen mangësi).
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Menjëherë dhe në vijimësi
Statusi i rekomandimit	Nuk është paraqitur koment mbi gjetjen

- Përlllogaritja e pagës bruto dhe neto në përputhje me emërtesën në strukturë dhe me vendimin përkatës të Këshillit të Ministrave.

Nga auditimi rezultoi se paga bruto e punonjësve me arsim të lartë është kryer konform emërtesës në strukturë dhe Lidhjes nr.1 “Kategoritë, Vjetërsia, Shtesa e Pozicionit” dhe Lidhjes nr.2 “Paga e Grupit”, të VKM nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve”, i ndryshuar me VKM nr.621, date 28.09.2022 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve në disa institucione të administratës publike”.

Përsa i përket pagës së punonjësve mbështetës dhe shtesave mbi pagë për punë të vështirë e të dëmshme për shëndetin, rezultoi se janë përlllogaritur konform VKM nr. 717, datë 23.06.2009 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të nëpunësve të disa institucioneve

buxhetore”, i ndryshuar me VKM nr.202, datë 15.03.2017 “Për pagat e punonjësve mbështetës të institucioneve buxhetore dhe të punonjësve në disa Institucione buxhetore”- Lidhja II, i ndryshuar me VKM nr.234, datë 20.04.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”- Lidhja II dhe Lidhja II/1, i ndryshuar me VKM nr.627, datë 28.09.2022 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe të punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa Institucione të Administratës Publike”,- Lidhja II.

Nga krahasimi i pagës së grupit për punonjësit me arsim të lartë me nivelin e diplomës që ata zotërojnë, rezultoi se përcaktimi i këtij elementi të pagës është kryer konform Lidhjes nr. 2 “Paga e Grupit”, të VKM-së nr. 187, datë 8.3.2017 “Për miratimin e strukturës dhe niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve ...”, i ndryshuar.

Listë pagesat e punonjësve janë përgatitur sipas listëprezencës mujore analitike të punonjësve, gjithsej 22 ditë pune, e nënshkruar nga përgjegjësjë e sektorit të financës dhe shërbimeve, nga përgjegjësit e sektorëve të tjerë dhe nga drejtori i institucionit. Por, Referuar paragrafit nr. 69, të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, *“listëpagesat plotësohen nga punonjësi i caktuar për pagat, duke u mbështetur në të dhënat e dokumentacionit bazë (listëprezenca e firmosur nga menaxheri i strukturës përkatëse) për shërbimin e kryer. Ato kontrollohen dhe nënshkruhen nga punonjësi i caktuar me menaxhimin e burimeve njerëzore dhe nëpunësi zbatues ose i deleguari i tij”*, prandaj rekomandohet nënshkrimi i listëprezencave analitike, edhe nga punonjësja e burimeve njerëzore, dhe pastaj të miratohen nga drejtori i institucionit.

Gjatë likuidimit të pagave të punonjësve në DRTK Shkodër nëpërmjet urdhër-shpenzimeve mujore, u konstatua se në çdo likuidim mungon listë prezencë e punonjësve të administratës dhe punonjësve mbështetës sipas sektorëve për periudhën qershor 2020- dhjetor 2021; por ato ishin administruar për të gjitha muajt në një dosje të veçantë. Listëprezencat mujore të punonjësve të mos mbahen në dosje të veçantë, por të bashkëlidhen në listëpagesat mujore të kaluara nëpërmjet degës së thesarit.

- Administrimi i dosjeve të personelit.

Nga auditimi i dosjeve të personelit, u konstatua se Institucioni ka administruar dosjet e personelit në përputhje me kërkesat e VKM nr. 117, datë 05.03.2014 “Për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit” dhe me kërkesat e VKM nr. 833, datë 28.10.2020 “Për rregullat e hollësishme për përmbajtjen, procedurën dhe administrimin e dosjeve të personelit e të regjistrit qendror të personelit”. Nga 13 dosje të përzgjedhura rezultoi se kanë fletë inventari me listën e gjithë dokumentacionit që ndodhet në dosje; fletën prezantuese të dosjes teknike të nëpunësit dhe dokumentat përkatës, si certifikatë e gjendjes familjare; diplomë e shollës së mesme, diplomë e shkollës së lartë/lista e notave; raport mjeko ligjor për qënien i aftë për punë; CV dhe kontrata individuale, etj. Në dosjet e punonjësve të administratës ndodhet edhe përshkrimi i vendit të punës. Të gjitha dosjet e punonjësve kanë fletë inventari të nënshkruar nga nëpunësi i personelit, *por të panënshkruara nga drejtori i institucionit.*

Pavarësisht punës së mirë të kryer lidhur me respektimin e numrit të punonjësve dhe përlllogaritjen e pagës së punonjësve, mjedisi i kontrollit duhet të përmirësohet më tej, duke vazhduar marrjen në punë të punonjësve nëpërmjet shpalljes së vendeve vakande në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe faqen zyrtare të institucionit, për të siguruar transparencë e konkurrencë gjatë procedurave të

punësimi. Strukturat përkatëse në vijimësi duhet të kryejnë vlerësimin vjetor të punonjësve, si proces i identifikimit të nevojave për trajnime, por edhe i motivimit të punonjësve në punë. Rregullore e brendshme e institucionit duhet të rishikohet në lidhje me përcaktimet e procedurave të punësimi, rishikim i cili i shërben përmirësimi të mjedisit të kontrollit.

IV.3. Sistemi i krijimit dhe përdorimit të të ardhurave dytësore

Objektivi i auditimit: Vlerësimi i zbatimit të Rregullores mbi funksionimin e sistemit të biletarisë në institucionet e trashëgimisë kulturore si dhe vlerësimi i krijimit e përdorimit të të ardhurave dytësore.

Fushat që do të merren në konsideratë gjatë auditimit:

- Zbatimi i Rregullores mbi funksionimin e sistemit të biletarisë në institucionet e trashëgimisë kulturore.

Nga auditimi i kryer në lidhje me këtë fushë, në Parkun Kombëtar Arkeologjik, Kalaja Shkodër, rezulton se institucioni ka përmbushur detyrat sipas përcaktimit në paragrafin me nr.3, të Kapitullit II, të Rregullores mbi funksionimin e sistemit të biletarisë në institucionet e trashëgimisë kulturore (në vijim Rregullores), konkretisht:

Në rastet e konstatimit të problematikave është raportuar në Ministrinë e Kulturës, sipas Procesverbalit, të Ankesit nr.1, të Rregullores;

Janë afishuar në vend të dukshëm çmimet dhe formati i biletës, orari i vizitave si dhe kategoritë që përfitojnë nga reduktimet, sipas përcaktimit të bërë në urdhrin e Ministrit të Kulturës;

Janë afishuar dhe publikuar në vend të dukshëm rregullat që zbatojnë vizitorët brenda Kalasë si dhe informacionet e tjera të nevojshme, si ditët falas dhe mundësia e parkimit.

Drejtuesi i institucionit të ketë në vëmendje zbatimin e germës g), të paragrafit nr.3, kapitullit II, të Rregullores, sipas të cilit institucioni i specializuar i trashëgimisë kulturore, pra DRTK Shkodër në këtë rast, publikon në website apo mjete të tjera informimi, detyrimin e enteve përkatëse/subjekteve për grupet të organizuara të nxënësve (mbi 50 veta), për të njoftuar një javë përpara sitin/muzeun në lidhje me ditën e vizitës së tyre si dhe rregulla të tjera që ndjekin institucionet arsimore apo subjekte të tjera private dhe shtetërore në lidhje me vizitat e grupeve.

Shënim i audituesit: Nga eksplorimi i faqes zyrtare të këtij institucioni drtkshkoder.com rezultoi se nuk është publikuar ky rregull.

Gjatë punës në terren nga stafi i këtij institucioni, duke filluar nga drejtuesi, përgjegjësi i financës, biletashitësit, u bë prezent problemi i administrimit të dokumentit justifikues, ose/dhe ID, që vërteton përkatësinë në kategorinë që përfiton hyrja pa pagesë ose biletë me çmim të reduktuar, të lëshuar nga institucioni përkatës, sipas përcaktimit në paragrafin me nr.9, të Kapitullit III, të Rregullores.

Gjatë vizitave familjare, pra prindërit të cilët shoqërojnë fëmijët nuk kanë dëshirë të vendosin në dispozicion ID e fëmijëve, të cilët përfitojnë hyrje falas ose hyrje me çmim të reduktuar, sipas përcaktimit në germën k), paragrafit me nr.1; germës b), të paragrafit me nr.2; të Lidhjes nr.3, të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr.715, datë 10.12.2019 “Për miratimin e formatit, çmimit, kategorisë dhe mënyrës së emetimit të biletave për muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publik, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.

(germa k, paragrafi me nr.1, citon: “fëmijët nën moshën 12 dymbëdhjetë vjeç, shoqëruar me dokumentin zyrtar provues” ndërsa germa b), paragrafi me nr.2 citon: “fëmijët nga mosha 12-18

vjeç, të paisur me dokumentin zyrtar provues, të cilët përfitojnë reduktim në masën 70% të çmimit të biletave”).

Në kushtet në të cilat në hyrje të Parkut Kombëtar Arkeologjik, Kalaja Shkodër, ndodhet vetëm një turnstile, gjatë sezonit turistik kur numri i vizitorëve në kala rritet jashtëzakonisht, është e pamundur kërkesa e biletashitësve drejtuar prindërve për paraqitjen e ID, sepse jo vetëm has në rezistencë nga prindërit, por krijon edhe rradhë të gjatë hyrjeje.

Në lidhje me këtë problem sqarojmë subjektin e audituar se gjatë përgatitjes së Memos mbi përfundimet e këtij angazhimi auditimi, ky problem do t'i adresohet Ministrit të Kulturës.

- Krijimi, evidentimi, administrimi dhe përdorimi i të ardhurave nga shitja e biletave, sipas akteve nënligjore në fuqi për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave.

Të ardhurat kryesore institucioni i siguron nga shitja e biletave të Parkut Kombëtar Arkeologjik, Kalaja Shkodër dhe Parkut Kombëtar Arkeologjik, Kalaja Lezhë.

Nga verifikimi rezulton se çmimi i biletës për vizitorët pranë dy Parqeve Kombëtare Arkeologjike Kalaja Shkodër dhe Kalaja Lezhë është aplikuar sipas sipas përcaktimit në paragrafin me nr.1 e paragrafin me nr.2, të Urdhrit të Ministrit të Kulturës nr.715, datë 10.12.2019 “Për miratimin e formatit, çmimit, kategorisë dhe mënyrës së emetimit të biletave për muzetë me status kombëtar, muzetë qendror publik, monumentet e kulturës dhe parqet arkeologjike, në varësi të Ministrisë përgjegjëse për trashëgiminë kulturore”, i ndryshuar.

Referuar Akt Rakordimit të të ardhurave, konfirmuar edhe nga dega e thesarit rezulton se:

Gjatë vitit 2020 shuma e të ardhurave gjithsej është 4,651,679 lekë; prej të cilës 4,447,440 lekë janë krijuar nga shitja e biletave pranë Parkut Kombëtar Arkeologjik, Kalaja Shkodër dhe Parkut Kombëtar Arkeologjik, Kalaja Lezhë.

Gjatë vitit 2021 shuma e të ardhurave të krijuara është 11,286,860 lekë; prej të cilës 11,284,860 lekë janë krijuar nga shitja e biletave (Kalaja Shkodër dhe Kalaja Lezhë).

Për periudhën janar-tetor 2022 shuma e të ardhurave të krijuara nga shitja e biletave është 16,602,120 lekë (shuma e të ardhurave gjithsej është 16,607,370 lekë).

Sikurse vërehet, pandemia botërore Covid 19 ka ndikuar edhe në numrin e vizitorëve e për pasojë edhe në të ardhurat e krijuara gjatë vitit 2020, me një përmirësim gjatë vitit 2021 dhe përmirësim të ndjeshëm gjatë vitit 2022 (periudha 10-mujore).

Meqenëse Parku Kombëtar Arkeologjik Kalaja Shkodër funksionon me sistem të biletarisë elektronike, çdo mandat arkëtim i regjistruar në librin e arkës shoqërohet me këto dokumente: Procesverbal javor me data analitike të mbajtur midis biletashitësit, financierit dhe drejtorit të institucionit, shoqëruar me mbylljen ditore të sistemit të biletarisë elektronike (cash out report dhe deposit report).

Çdo mandat pagese shoqërohet me faturën për arkëtim dhe derdhjen për thesarin.

Nga verifikimi i regjistrimit të veprimeve të librit të arkës dhe regjistrimit në ditarin e bankës, rezultoi se për periudhën e audituar shuma totale mujore e arkëtimeve sipas librit të arkës përputhet me shumën totale mujore të pagesës sipas mandatit dhe shumën e regjistruar në ditarin e bankës.

Përsa i përket përdorimit të të ardhurave dytësore për periudhën e audituar, të ardhurat nga shitja e biletave janë përdorur sipas përcaktimit të paragrafit nr.3.3, të Udhëzimit të Përbashkët nr.52, datë 9.2.2015 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të Ministrisë së Kulturës”, sipas të cilit 10 % derdhen në buxhetin e shtetit dhe 90% për institucionin si dhe sipas limitit të miratuar për përdorimin e të ardhurave.

Për vitin ushtrimor janar-dhjetor 2020, limiti i përdorimit të të ardhurave është 4,500,000 lekë dhe përdorimi i të ardhurave në fakt është 2,377,439 lekë; pra realizimi i të ardhurave është në masën 53%; nivel mjaft i ulët. Realizim i ulët paraqitet në mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës, procedura të cilat nuk arrihen të realizohen, por anulohen për mungesë pjesëmarrjeje.

Të ardhurat janë përdorur për mbulimin e shpenzimeve operative për blerjen e biletave të vizitorëve (960 mijë lekë), mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës (1,228 mijë lekë) dhe shërbimin e fletëpalosjeve për parqet Shkodër Lezhë (90 mijë lekë).

Limiti maksimal i përdorimit të të ardhurave gjatë vitit 2021 ka qenë 400,000 lekë (mjaft i ulët) dhe përdorimi i të ardhurave në fakt është në shumën 358,800 lekë; realizimi në masën 90%.

Të ardhurat janë përdorur për blerjen materialeve e shërbimeve si fletë palosje dhe panele informuese, si dhe mbjellje fidanesh për gjelbërim në parqet arkeologjike.

Për periudhën janar-tetor 2022 përdorimi i të ardhurave dytësore është në vlerën prej 767,970 lekë, ndërkohë që plani i miratuar është 5,000,000 lekë. Pavarësisht se ky përdorim i përket periudhës dhjetë mujore dhe jo vitit ushtrimor, drejtuesi i këtij institucioni duhet të maksimizojë përdorimin e të ardhurave sipas limitit vjetor të miratuar, në funksion të arritjes së objektivave kryesore vjetore në përputhje me misionin e institucionit.

Edhe gjatë periudhës janar-tetor 2022, sikurse gjatë vitit 2021, shumta e shpenzimeve për mirëmbajtjen e monumenteve të kulturës është 0 lekë, për arsye të anulimit të procedurave të konkurrimit publik, si pasojë e mungesës së pjesëmarrjes.

- Vlerësimi i aktiviteteve të kontrollit mbi gjendjen e letrave me vlerë dhe gjendjen monetare në arkë.

Nga auditimi i veprimeve të kryera nëpërmjet arkës rezultoi se arkëtimi i vlerave monetare të krijuara nga shitja e biletave në Kalanë Shkodër nga biletashitësi në arkën e institucionit, për periudhën e audituar qershor 2020 – maj 2022 ka një frekuencë prej një javë; pra arkëtimi i vlerave monetare nga biletashitësi të arkëtari kryhet një herë në javë, pavarësisht se sa është shumta totale e arkëtuar.

Duke filluar nga muaji qershor e në vijim, frekuenca është më e shpeshtë, sepse derdhja e të ardhurave në bankë kryhet pas arritjes së limitit maksimal prej 50,000 lekë.

Në urdhrin e Drejtorit të DRTK Shkodër nr. 103, datë 26.05.2022 “Për funksionimin e biletarisë të Kalasë Rozafa dhe Kalasë Lezhë”, konkretisht në paragrafin me nr.6 është përcaktuar vlera monetare maksimale në arkë, në shumën prej 50,000 lekësh dhe në paragrafin me nr.7 është përcaktuar monitorimi i dy biletarive dy herë në javë nga përgjegjësi i Sektorit të Parkut Arkeologjik dhe specialiste e Sektorit.

Ndërsa në Urdhrin nr. 174, datë 12.09.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr. 103, datë 26.05.2022 “Për funksionimin e biletarisë të Kalasë Rozafa dhe Kalasë Lezhë” është përcaktuar që xhiroja ditore e Kalasë Rozafa depozitohet në bankë çdo ditë në përmbyllje të turnit dhe frekuenca e kryerjes së kontrollit është një herë në javë.

Nga verifikimi i dokumentacionit të përzgjedhur për periudhën janar-tetor 2022, rezultoi se nga grupet e inspektimit janë kryer dhe dokumentuar kontrollet pranë Kalave, sipas përcaktimit në urdhrin e Drejtorit të DRTK Shkodër nr. 103, datë 26.05.2022 “Për funksionimin e biletarisë të Kalasë Rozafa dhe Kalasë Lezhë”, të ndryshuar.

Në bazë të një prej metodave të auditimit të përcaktuara në Programin e Angazhimit të Auditimit, konkretisht “Inspektimi fizik”, gjatë punës në terren në prezencë të audituesit të brendshëm, u ushtrua një kontroll pranë biletarisë elektronike në Kala, i cili është dokumentuar sipas proces verbalit të datës 21.12.2022.

Në drejtim të administrimit të vlerave monetare të krijuara nga shitja e biletave rezultoi se sporteli i biletarisë elektronike në Kalanë Shkodër nuk është i paisur me kasafortë; pra biletashitësit administrojnë vlerat monetare në sirtar.

Punonjësi i ngarkuar me kryerjen e veprimeve të arkës, pranë zyrës së financës, është i paisur me kasafortë; në përputhje me përcaktimin e paragrafit nr. 72, të Udhëzimit nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik”, i ndryshuar, sipas të cilit: “Vlerat monetare dhe të barazvlershme me to ruhen në kasafortën e njësisë dhe janë në përgjegjësi të punonjësit të ngarkuar me veprimet e arkës në vartësi të nëpunësit zbatues”.

Pavarësisht respektimit të përcaktimit në paragrafin nr.72, të udhëzimit, cituar si më sipër, referuar mënyrës së funksionimit të biletarive, audituesi i brendshëm sjell në vëmendjen e drejtuesit të kësaj njësie se edhe biletashitësit duhet të paisen me kasafortë ose aktive ekuivalente për ruajtjen e vlerave monetare.

Në përfundim të trajtimit të këtij sistemi vlerësojmë perpjekjet e stafit të DRTK Shkodër për respektimin e Rregullores së miratuar nga Ministri i Kulturës mbi funksionimin e sistemit të biletarisë në institucionet e trashëgimisë kulturore, përveç administrimit të dokumentacionit justifikues ose/dhe ID, që vërteton përkatësinë në kategorinë që përfiton hyrja pa pagesë ose biletë me çmim të reduktuar, të lëshuar nga institucioni përkatës (problem i adresuar nga stafi gjatë punës në terren).

Duke vlerësuar masat e marra në drejtim të administrimit të vlerave monetare pranë biletarive të Parqeve Arkeologjike Kalaja Shkoder e Kalaja Lezhë, audituesi i brendshëm vë theksin në vijueshmërinë e monitorimit efektiv të biletarive, veçanërisht pranë Kalasë Shkodër, e cila frekuentohet nga një numër i madh vizitorësh.

IV.4. Të tjera

- Probleme të ndryshme të konstatuara gjatë punës në terren.

Gjatë punës në terren nuk u konstatuan probleme të tjera, përveç problemeve të trajtuara si më sipër.

IV.5. Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit

Mjedisi i kontrollit - DRTK Shkodër funksionon sipas VKM nr.581, datë 28.08.2019 “Për funksionimin dhe mënyrën e zhvillimit të veprimtarisë së drejtorive rajonale të trashëgimisë kulturore”; organikës së miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 139, datë 21.10.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Drejtorive Rajonale të Trashëgimisë Kulturore”; Rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm miratuar nga Ministri i Kulturës me Urdhrin nr.161 ,datë 07.05.2020 “Për miratimin e rregullores për organizimin dhe funksionimin e brendshëm për Drejtorinë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër”.

Në nenin 26, të Rregullores së Brendshme janë përcaktuar Rregullat e Etikës; ndërsa në nenin 44 të Rregullores është përcaktuar Parandalimi i Konfliktit të Interesit.

DRTK Shkodër nuk ka një statut të miratuar nga Ministri i Kulturës.

Pavarësisht se marrja në punë e Përgjegjësit të Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse është kryer nëpërmjet një procesi transparent, sikurse është trajtuar në sistemin e menaxhimit të burimeve njerëzore, rregullore e brendshme duhet të rishikohet në lidhje me procedurat e marrjes në punë, procedura të cilat duhet të sigurojnë në çdo rast transparencë dhe konkurrencë.

-Vlerësimi i rrezikut- Gjatë punës në terren nuk është vendosur në dispozicion regjistri i menaxhimit të risqeve të institucionit për vitet ushtrimore periudhë auditimi.

Sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, theksojmë se jo vetëm që duhet të hartohet regjistri i riskut për çdo vit ushtrimor, por ky dokument duhet të jetë objekt rishikimi, të paktën dy herë gjatë çdo viti ushtrimor.

Aktivitetet e kontrollit- Referuar gjetjeve të trajtuara në këtë material rezulton se nuk kanë funksionuar kontrollet parandaluese e zbuluese.

Gjatë kryerjes së procedurave të prokurimit publik nuk janë ushtruar gjithë aktivitetet e kontrollit, sipas përcaktimit në bazën ligjore përkatëse, ndër të cilat më kryesoret janë: mungesa e deklarimit të konfliktit të interesit; mungesa e testimit të tregut, si alternativë referuese për përlogaritjen e fondit limit, për procedurat e blerjeve të vogla nën dhe mbi 100,000 lekë pa tvsh.

Gjatë përlogaritjes së pagës së punonjësve kanë munguar kontrollet parandaluese e zbuluese në lidhje me rakordimin e vjetërsisë së punës mes listëpagesës dhe librezës së punës të punonjësve, duke shkaktuar në një rast shlyerje me vonesë të vjetërsisë në punë.

Përveç aktiviteteve efektive të kontrollit, ka munguar edhe monitorimi i vazhdueshëm i punës së kryer nga përgjegjësi i sektorit.

Informacioni dhe komunikimi- Shkëmbimi i informacioneve ndërmjet punonjësve të të gjithë niveleve është kryer si horizontalisht dhe vertikalisht. Dokumentet hyrëse dhe dalëse janë komunikuar në formën dhe kohën e duhur.

Monitorimi- Nisur nga gjetjet e konstatuara nga auditimi, vlerësojmë se ka munguar monitorimi sipas hierarkisë, me theksin të monitorimi i vazhdueshëm i punës së kryer nga çdo punonjës, sepse numri i punonjësve është i vogël. Pra është i rëndësishëm vet monitorimi i vazhdueshëm nga çdo punonjës.

Titulli i gjetjes: Mungesa e statutit dhe e hartimit të regjistrit të menaxhimit të riskut; rishikimi i rregullores së brendshme.

Gjetje nr. 1	
Subjekti i audituar	DRTK Shkodër
Subjektet e interesuara nga gjetja	Ministria e Kulturës Drejtori Përgjegjësi i Sektorit të Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse
Përmbledhja bazës ligjore	Ligji nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin; Udhëzimi i Ministrisë të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Rregullore e brendshme.
Përshkrimi i gjetjes	Situata: DRTK Shkodër nuk ka një statut të miratuar nga Ministri i Kulturës. Referuar pikës 1 dhe 2 të VKM nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e

	buletinit të njoftimeve publike”, institucionet shtetërore duhet t'i publikojnë njoftimet për vendet vakante të punës në Buletinin e Njoftimeve Publike. Sipas Rregullores së brendshme të institucionit, neni 19, pika 2, citohet: “Punëdhënësi për të emëruar punëmarrësin <i>mund</i> të përdorë shërbimet e zyrave shtetërore të punësimit ose të agjencive private të punësimit; dhe pika 3: “Punësimi <i>mund</i> të kryhet nëpërmjet përzgjedhjes sipas procedurës së konkurimit publik”, gërmat a); b); c); d); e); f); etj”; pra duhet të rishikohet përcaktimi i punësimit: nga “mund” të bëhet “duhet”. Gjatë punës në terren nuk është vendosur në dispozicion regjistri i menaxhimit të risqeve të institucionit për vitet ushtrimore periudhë auditimi. Sipas përcaktimeve në Udhëzimin nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”, theksojmë se jo vetëm që duhet të hartohet regjistri i riskut për çdo vit ushtrimor, por ky dokument duhet të jetë objekt rishikimi, të paktën dy herë gjatë çdo viti ushtrimor. Vlen të theksojmë se vlerësimi i rrezikut nuk duhet të jetë thjesht një proces formal, pra nëse hartohet e miratohet regjistri i riskut të konsiderohet se është kryer plotësisht ky proces; por duhet të shoqërohet me vlerësim dhe monitorim të kontrolleve të ngritura. Kriteri: paragrafi me nr.7, i nenit 31, të Ligjit nr.27/2018 “Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë”; Ligji nr.10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar; Manuali për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, miratuar me urdhrin e Ministrit të Financave nr.8980, datë 15.07.2010; Udhëzimi i Ministrit të Financave nr. 16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Ndikimi/Efekti: Me miratimin e Statutit, institucioni do të funksionojë me një mjedis kontrollit të përmirësuar. Me hartimin e regjistrit të riskut dhe rishikimin gjatë vitit ushtrimor të procesit të menaxhimit të riskut e monitorimin e këtij procesi, sigurohen aktivitete efektive të kontrollit, të cilat mundësojnë minimizimin e riskut të identifikuar për arritjen e objektivave. Shkak: Mungesa e përditësimit me aktet ligjore/nënligjore në fuqi.
Vlerësimi i nivelit të riskut	I lartë
Konkluzioni	Pavarësisht përpjekjeve për ngritjen e një sistemi efektiv të kontrollit të brendshëm, mjedisi i kontrollit duhet të përmirësohet më tej nëpërmjet

	miratimit të Statutit. Procesi i vlerësimit të rrezikut duhet të përkthehet në aktivitete kontrolli efektive parandaluese, zbuluese e drejtuese. Monitorimi i këtij procesi duhet të mundësojë përshtatjen dhe ngritjen e kontrolleve, sipas dinamikave të identifikimit të riskut.
Rekomandimi	Të përcillet draft Statuti i institucionit pranë Ministrisë së Kulturës, për rishikim dhe miratim. Të rishikohet neni 19, pika 2 dhe pika 3 (germa b, d, f), i Rregullores së Brendshme, i cili duhet të përcaktojë saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të konkurimit publik. Të hartohet regjistri i riskut të vitit 2023, i cili duhet të integrojë risqet e identifikuara nga çdo sektor.
Afati i fundit për zbatimin e rekomandimit	Draft Statuti dhe Rregullore e Brendshme e rishikuar, të përcillen pranë MK brenda muajit qershor 2023. Regjistri i riskut të hartohet menjëherë
Statusi i rekomandimit	Nuk është paraqitur koment për gjetjen

V. Rekomandimet.

Në përfundim të procesit të vlerësimeve të bëra nga grupi i auditimit, bazuar në germën “c” të nenit 6, dhe germën “e” të nenit 16, të Ligjit nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, për arritjen e objektivave të Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, si dhe për të rritur efektivitetin në punën, funksionimin dhe drejtimin e këtij institucioni, referuar trajtimit të gjetjeve, janë lënë për zbatim 7 (shtatë) rekomandime.

Bashkëlidhur Raportit Përfundimtar Aneksi 1, i rishikuar, Rekomandimet.

Raporti Përfundimtar i Auditimit hartohet në tre kopje të barabarta, një prej të cilave i dërgohet subjektit të audituar “DRTK Shkodër”; një kopje administrohet në dosjen korente të Sektorit të Auditimit të Brendshëm dhe një kopje administrohet në zyrën e protokollit të MK.

Grupi i auditimit

Silvana GUSHALI

Festim IBRAHIMI



Aneksi nr. 1, i rishikuar


PËRMBLEDHËSE E REKOMANDIMEVE

Nr.	Rekomandimet	Niveli i Riskut
1	Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të kryejë testimin e tregut e të dokumentojë treguesit e çmimeve në një procesverbal dhe të përcaktojë fondin limit në procedurat e prokurimit.	I mesëm
2	Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël të deklarojnë mbi gjendjen e konfliktit të interesit, nëpërmjet nënshkrimit të një deklarate.	I mesëm
3	Në rastet e procedurave emergjente, përveç të tjerave, të dokumentohen me Formularin nr. 4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës”.	I ulët
4	Të kryhet vlerësimi objektiv vjetor i performancës së punonjësve mbi bazën e objektivave individuale vjetore, si dhe të identifikohen nevojat për trajnime të punonjësve (në rastet kur konstatohen mangësi).	I lartë
5	Të përcillet draft Statuti i institucionit pranë Ministrisë së Kulturës, për rishikim dhe miratim.	I lartë
6	Të rishikohet neni 19, pika 2 dhe pika 3 (germa b, d, f), i Rregullores së Brendshme, i cili duhet të përcaktojë saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të konkurimit publik.	I lartë
7	Të hartohet regjistri i riskut të vitit 2023, i cili duhet të integrojë risqet e identifikuara nga çdo sektor.	I lartë

Grupi i auditimit

Silvana GUSHALI

Festim IBRAHIMI



OBSERVACIONET

Observacion mbi Sistemin e Prokurimeve të Fondeve Publike

Observacioni i Gjetjes nr. 2	Në observacionin e Drejtorit të DRTK Shkodër, dërguar me shkresën nr. 140/2 prot., datë 25.04.2023 (nr. hyrës në MK 6681/4 prot., datë 07.04.2023), mbi gjetjen nr.2 të këtij sistemi, citohet: <i>“Në procedurën e blerjes së zhvilluar në rrugë elektronike për vitin 2020 me objekt “Blerje biletash elektronike për vizitorë”, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në praktikën e kësaj blerje, e ka nënshkruar deklarimin e konfliktit të interesit, bashkëlidhur kësaj shkrese.</i> <i>Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël është treguar i kujdesshëm në respektimin e parashikimit ligjor dhe të rekomandimeve të lëna nga raporti i auditimit i vitit 2020, ku në çdo blerje me vlerë mbi 100.000 lekë deri në 1.000.000 lekë pa TVSH të zhvilluar në mënyrë elektronike, ka nënshkruar deklarimin e interesit me 2 deklarata, në çdo fillim viti kur është krijuar ky komision dhe në momentin e hapjes së ofertave për çdo blerje.</i> <i>Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël për këtë blerje ka mbajtur një procesverbal, me treguesit e çmimeve, ku nga këto tregues ka përllogaritur edhe fondin limit. Kjo është reflektuar në procesverbalin me nr. 108/4 prot, datë 10.03.2020, bashkëlidhur kësaj shkrese.</i> <i>Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. në paragrafin e dytë të pikës 7 shprehet: “ <u>Në rastet kur, në përllogaritjen e fondit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij procesi. Por vetëm treguesit e çmimeve, të cilët dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël”.</u></i>
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr.2	Sipas observacionit të paraqitur nga subjekti, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit, anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, janë përgjegjës për të respektuar përcaktimet ligjore. Së pari, gjatë punës në terren nuk u gjetën të bashkëlidhur deklaratat e konfliktit të interesit në dokumentat e thesarit. Megjithatë për sa i përket gjetjes nr. 2, në 13 procedura të prokurimit me vlera të vogla të drejtëpërdrejta dhe elektronike, mungonte formulari i deklarimit të konfliktit të interesit, nëpërmjet të cilit anëtarët e komisionit të blerjeve të vogla vetëdeklarojnë nëse ndodhen ose jo në kushtet e konfliktit të interesit për periudhën e vitit 2020, 2021 dhe 10-mujori 2022. Autoriteti kontraktor nuk ka zbatuar detyrimin ligjor për deklarimin e gjendjes së konfliktit të interesit, në momentin e cakimit në komision të blerjeve me vlera të vogla, si dhe në momentin e hapjes së ofertave ekonomike të paraqitura nga subjektet konkurrese.

	<i>Së dyti</i>, sipas observacionit nr. 140/2 prot, datë 05.04.2023, subjekti ka pranuar se deklarimi i konfliktit të interesit mungon në 12 procedura, nga 13 procedura prokurimi me blerje me vlera të vogël të vlerësuara nga auditimi. Referuar deklaratave të konfliktit të interesit të bashkëlidhur Observacionit, rezultoi se është pranuar vetëm për një procedurë deklarata e konfliktit të interesit, e konkretisht për procedurën me objekt “Blerje biletash elektronike për vizitor”. Ndërsa në 12 procedurat e tjera subjekti nuk ka dërguar deklaratat e konfliktit të interesit bashkëlidhur observacionit, pra në thelb gjetja nr.2 egziston dhe nuk ka ndryshuar, pasi subjekti ka pranuar në 12 procedura prokurimi mungesën e deklaratave të konfliktit të interesit. <i>Së treti</i>, për sa i përket procedurës së prokurimit elektronik për “Blerje biletash elektronike për vizitor” me vlerë 948,000 lekë, audituesi ka konstatuar mungesën e testimit të tregut dhe të përcaktimit të fondit limit për vitin 2020. Institucioni ka dërguar proces-verbalin nr.108/4 prot, datë 10.03.2020 të testimit të tregut dhe fondit limit të bashkëlidhur observacionit, që pranohet për procedurën “Blerje biletash elektronike për vizitor”, sipas pikës 2 të gjetjes nr.1. Por testimi i tregut mungon për procedurat e pikës 1, në 6 raste prokurimi nga 7 procedura prokurimi të vlerësuara nga auditimi. Pra në thelb edhe gjetja nr.1 egziston dhe nuk ka ndryshuar, pasi subjekti ka pranuar në 6 procedura prokurimi mungesën e administrimit të ofertave për testimin e tregut në vitin 2020. Subjekti gjithashtu pretendon që sipas Udhëzimit nr.5, datë 25.06.2021, pika 7, nuk është i domosdoshëm administrimi i ofertave të marra në kuadër të këtij procesi, por ky pretendim i përket periudhës qershor 2021 e në vijim. Ndërsa procedura më lart i përket vitit 2020, ku duhej vepruar sipas udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018, mbi bazën e të cilit administrohen ofertat e testimit të tregut dhe mbahet proces verbal për treguesit e çmimeve ku sipas të dhënave të ofertave përcaktohet fondi limit. Bazuar në argumentet dhe shpjegimet e mësipërme, audituesi nuk ndryshon qëndrimin ndaj gjetjes dhe konkluzionit përfundimtar për gjetjen.
Rishikimi i statusit të Gjetjes nr. 2	Nuk ndryshon statusi i gjetjes nr.2, është rishikuar trajtimi i gjetjes referuar dokumenteve të dërguara bashkëlidhur observacionit.
Rishikimi i nivelit të riskut	Nuk ndryshon Niveli i Riskut në Gjetjen nr.2 të këtij sistemi.
Observacioni i Gjetjes nr. 1	Në observacionin e Drejtorit të DRTK Shkodër, mbi gjetjen nr.1 të këtij sistemi, citohet: <i>“Në procedurat e blerjeve të zhvilluara në rrugë elektronike për vitin 2021 dhe 10 mujorin e vitit 2022, për blerjet me vlerë mbi 100,000 lekë, me objekt “Shërbim telefoni fiks dhe interneti për zyrat e DRTK Shkodër dhe për Kalamë Rozafa”, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël në praktikën e kësaj blerje, ka administruar edhe ofertat e marra në kuadër të këtij procesi, ka përlogaritur fondin limit dhe e ka</i>

	reflektuar në procesverbalin e mbajtur me nr. 90/3, datë 22.02.2022, në mbështetje të Udhëzimit nr.5, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike", bashkëlidhur kësaj shkrese. Për blerjen "Blerje biletash për Kalanë Rozafa", komisioni ka kontaktuar nëpërmjet emailit zyrtar me 3 operatorë të cilët e ushtrojnë aktivitetin në gjetin e Tiranës, nga ku ka marrë edhe ofertat e tyre. Këto oferta i janë bashkëlidhur praktikës së blerjes, dhe më pas është përgatitur procesverbali i testimit të tregut dhe përlogaritjes së fondit limit me nr.266/6 prot, datë 20.09.2022, bashkëlidhur kësaj shkrese. Për blerjen "Blerje karburanti", komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka fotografuar 3 operatorë ekonomik, dhe në referim të çmimeve, ka hartuar procesverbalin e testimit të tregut për objektin e prokurimit "Blerje karburanti nga 1100 litra dhe benzinë 200 litra" nr.322 prot, datë 22.12.2021".
Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr.1	Referuar observacionit të paraqitur për gjetjen nr. 1 për vitin 2021 dhe 10-majori 2022, grupi i auditimit sqaron si më poshtë: Për sa i përket procedurave të prokurimit në gjetjen nr.1, në pikën 1 janë trajtuar 7 (shtatë) procedura të drejtëpërdrejta në vlerën 100,000 lekë, ndërsa në pikën 2 janë trajtuar 4 (katër) procedura elektronike në vlerën mbi 100,000 lekë, në të cilat audituesi ka konstatuar mungesën e testimit të tregut dhe përcaktimin e fondit limit për blerjet e kryera. Sipas observacionit bashkëlidhur, pretendimet e subjektit pranohen për procedurat elektronike në pikën 2 të gjetjes nr. 1, me objekt: "Shërbim telefoni fiks dhe interneti për zyrat e DRTK Shkodër dhe për Kalanë Rozafë", "Blerje karburant", "Shërbim telefoni fiks dhe interneti për zyrat e DRTK Shkodër dhe për Kalanë Rozafë", "Blerje Bileta për Kalanë Rozafë". Ndërsa për 7 procedurat e prokurimit me vlera të vogla të pikës 1, mungon testimi i tregut dhe procesverbali i fondit limit. Pra në thelb edhe gjetja nr.1 egziston dhe nuk ka ndryshuar, pasi subjekti ka pranuar në 7 procedura prokurimi me vlera te vogla, mungesën e testimit dhe përcaktimin e fondit limit. Bazuar në argumentet dhe shpjegimet e mësipërme, audituesi nuk ndryshon qëndrimin ndaj gjetjes dhe konkluzionit përfundimtar për gjetjen.
Rishikimi i statusit të Gjetjes nr. 1	Nuk ndryshon statusi i gjetjes nr.1, është rishikuar trajtimi i gjetjes referuar dokumenteve të dërguara bashkëlidhur observacionit.
Rishikimi i nivelit të riskut	Nuk ndryshon Niveli i Riskut në Gjetjen nr.1 të këtij sistemi.
Observacioni i Gjetjes për blerjet me vlerë nën 100,000 lekë	Në observacionin e Drejtorit të DRTK Shkodër mbi gjetjen për blerjet nën 100,000 lekë të këtij sistemi, citohet: "Procedurat e blerjeve me vlerë nën 100,000 lekë pa TVSH, janë procedura të cilat nuk zhvillohen me Sistemin e Prokurimit Elektronik, dhe si të tilla, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël nuk ka nënshkruar

	deklarimet e konfliktit të interesit, në këto procedura nuk paraqiten ofertues, pasi nuk publikohet “Ftesa për ofertë”. Duke mos patur një rregullim ligjor specifik për këto blerje me vlerë nën 100,000 lekë, nuk janë mbajtur procesverbale përlogaritjesh të fondit limit. Megjithatë, në vitin 2022, në përmirësim të procedurave të këtyre blerjeve, dhe në frymën e Udhëzimit nr. datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, komisioni i prokurimit me vlerë të vogël ka mbajtur procesverbale me treguesit e çmimeve dhe të përlogaritjes së fondit limit”.
Konkluzion përfundimtar i audituesve për blerjet me vlerë nën 100,000 lekë	Referuar observacionit të paraqitur për blerjet me vlerë nën 100,000 lekë (gjetja nr. 1 dhe gjetja nr.2), grupi i auditimit sqaron si më poshtë: 1. Për sa i përket blerjeve me vlerë nën 100,000 lekë, autoriteti kontraktor ka pranuar që nuk ka nënshkruar deklarimet e konfliktit të interesit, me pretendimin se janë procedura që nuk zhvillohen me SPE, pasi nuk publikohet “Ftesa për ofertë”. Ky gjykim nuk pranohet, për arsye se edhe për këto raste prokurimi veçohet njësoj si procedurat mbi 100,000 lekë; për vitin 2022 vetë autoriteti kontraktor i ka përmirësuar duke nënshkruar deklarimet e konfliktit të interesit nga komisioni blerjeve. -Në pikën 2, të nenit 64, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Në momentin e hapjes së ofertave, zyrtarët e përfshirë në procesin e vlerësimit të ofertave nënshtruan një deklaratë përmes së cilës deklarojnë se nuk ndodhen në kushet e konfliktit të interesit me ofertuesit pjesëmarrës”; -Agjencia e Prokurimit Publik, në njoftimin nr. 6504/3 prot., datë 26.09.2018, drejtuar autoriteteve kontraktore ka dhënë sqarimin se, në bazë të dispozitës së sipërcituar, anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël, në momentin e hapjes së ofertave në procedurat përkatëse të prokurimit, kanë detyrimin të deklarojnë mbi gjendjen e konfliktit të interesit, nëpërmjet nënshkrimit të një deklaratë; -Në pikën 4, të nenit 73, të VKM nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet: “Kërkesat ligjore për parandalimin e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të mbahen parasysh në emërimin e çdo nëpunësi, të angazhuar në procesin e prokurimit. Çdo nëpunës, që merr pjesë në procesin e prokurimit, nënshkruan një deklaratë, përmes së cilës deklaron se nuk ndodhet në kushet e konfliktit të interesit”. 2. Për sa i përket blerjeve me vlerë nën 100,000 lekë, autoriteti kontraktor ka pranuar se nuk ka mbajtur procesverbale me treguesit e çmimeve dhe të përlogaritjes së fondit limit, me pretendimin se nuk ka patur një rregullim ligjor specifik. Ky gjykim nuk pranohet, sepse testimi i tregut për artikujt objekt prokurimi, kryhet njësoj si për blerjet me vlerë nën 100,000 lekë ashtu edhe për procedurat mbi 100,000 lekë dhe pas përcaktimit të fondit limit, del urdhëri i prokurimit për blerjet e vogla.


	Ndërsa për vitin 2022 autoriteti kontraktor i ka përmirësuar procedurat nën 100,000 lekë, duke mbajtur procesverbale me treguesit e çmimeve dhe të përlogaritjes së fondit limit. -Në pikën 5, të udhëzimit nr.3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin procedurës së prokurimit me vlerë të vogël”, përcaktohet: “Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël, pasi të ketë siguruar apo hartuar specififikimet teknike, duhet të përlogarisë fondin limit për sasitë e mallrave, shërbimeve, punëve që do të prokurohen, në përputhje me nenin 59, të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; -Sipas nenit 12 dhe 13, të VKM-së nr. 285, datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; -Në pikën 7, të udhëzimit nr. 5, datë 25.06.2021 “Për përdorimin e procedurës me vlera të vogla dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, përcaktohet: “Në rastet kur në përlogaritjen e fondit përdoret metoda e testimit të tregut, nuk është e domosdoshme të administrohen ofertat e marra në kuadër të këtij procesi, por vetëm treguesit e çmimeve, të cilat dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël”. Pretendimet e mësipërme të autoritetit kontraktor nuk qëndrojnë dhe nuk pranohen nga audituesi, sepse ato janë në formën e sqarimeve dhe jo të bazuara në aktet ligjore/nënligjore në fuqi për bletjet me vlera të vogla nën dhe mbi 100,000 lekë. Audituesi bazuar në argumentet dhe shpjegimet e mësipërme, nuk ndryshon qëndrimin ndaj gjetjes dhe konkluzionit përfundimtar për gjetjen.
Rishikimi i statusit të Gjetjes për bletjet me vlerë nën 100,000 lekë	Nuk ndryshon statusi për bletjet me vlerë nën 100,000 lekë,, është rishikuar trajtimi i gjetjes referuar dokumenteve të dërguara bashkëlidhur observacionit.
Rishikimi i nivelit të riskut	Nuk ndryshon Niveli i Riskut në Gjetjen për bletjet me vlerë nën 100,000 lekë të këtij sistemi.

Observacionet mbi Sistemin e pagave dhe menaxhimit të burimeve njerëzore

Observacioni i Gjetjes nr. 2	Në observacionin e Drejtorit të DRTK Shkodër, dërguar me shkresën nr.140/2 prot., datë 05.04.2023, mbi gjetjen nr.2 të këtij sistemi, citohet: “Gjetje nr. 2 <i>Për punonjësin H.S. marrëdhënia e punës referuar librezës së punës, ka filluar me datë 01.04.2006 dhe me 01.04.2023 mbush 17 vite punë. Në këto kushte DRTK Shkodër i ka paguar shtesën për vjetërsi në punë për 16 vite deri në muajin Mars 2023. Bashkëlidhur librezë e punës.”</i>
-------------------------------------	---

Konkluzion përfundimtar i audituesve për gjetjen nr. 2	Përsa më sipër, në kushtet e dokumentacionit bashkëlidhur (libreza e punës) sipas observacionit, punonjësit H.S i kanë paguar shtesën për vjetërsi në punë për 16 vite deri në muajin Mars 2023, e mbi këtë bazë, observacioni për këtë çështje pranohet dhe gjetja nr. 2 nuk do të trajtohet në Raportin Përfundimtar të auditimit, sepse nuk qëndron si gjetje.
Rishikimi i statusit të gjetjes nr. 2	Ka lidhje me trajtimin e konkluzionit përfundimtar
Rishikimi i nivelit të riskut	Ka lidhje me trajtimin e konkluzionit përfundimtar

Grupi i auditimit
 Silvana GUSHALI
 Festim IBRAHIMI



Model plan veprimi mbi zbatimin e rekomandimeve

Nr. Rek	Rekomandimet	Renditja sipas nivelit	Referenca e paragrafit në raport	Reagimi i menaxhim it të subjektit të audituar	Afati i përcaktuar	Personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve
1	Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël të kryejë testimin e tregut e të dokumentojë treguesit e çmimeve në një procesverbal dhe të përcaktojë fondin limit në procedurat e prokurimit.	I mesëm	Çështja IV.1. Sistemi i prokurimeve të fondëve publike; Gjetja nr.1		Në vijimësi	
2	Anëtarët e komisionit të prokurimit me vlerë të vogël të deklarojnë mbi gjendjen e konfliktit të interesit, nëpërmjet nënshkrimit të një deklaratë.	I mesëm	Çështja IV.1; Gjetja nr.2		Në vijimësi	
3	Në rastet e procedurave emergjente, përveç të tjerave, të dokumentohen me Formularin nr. 4 “Procesverbal i Rasteve të Emergjencës”.	I ulët	Çështja IV.1; Gjetja nr.3		Menjëherë dhe në vijimësi	
4	Të kryhet vlerësimi objektiv vjetor i performancës së punonjësve mbi bazën e objektivave individuale vjetore, si dhe të identifikohen nevojat për trajnime të punonjësve (në rastet kur konstatohen mangësi).	I lartë	Çështja IV.2 Sistemi i pagave dhe menaxhimi i burimeve njerëzore; Gjetja nr.1		Menjëherë dhe në vijimësi	

5	Të përcillet draft Statuti i institucionit pranë Ministrisë së Kulturës, për rishikim dhe miratim.			Brenda muajit qershor 2023.	
		I lartë	Çështja IV.5 Vlerësimi i komponentëve të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit; Gjetja nr.1		
6	Të rishikohet neni 19, pika 2 dhe pika 3 (germa b, d, f), i Rregullores së Brendshme, i cili duhet të përcaktojë saktë procedurat e rekrutimit nëpërmjet procedurave të konkurimit publik.	I lartë	Çështja IV.5; Gjetja nr.1	Brenda muajit qershor 2023.	
7	Të hartohet regjistri i riskut të vitit 2023, i cili duhet të integrojë risqet e identifikuara nga çdo sektor.	I lartë	Çështja IV.5; Gjetja nr.1	Menjëherë	

Mbyllet me nr.7 (shtatë).